



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 150, Datë 03.07.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI TË MODELIT TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 18 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2016/1719 TË DATËS 26 SHTATOR 2016 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË AVANCË”

Në mbështetje të neneve 16, 7, 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”; nenit 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016, nenit 26 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 03.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një Metodologji të Modelit të Përbashkët të Rrjetit në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një Udhëzuesi mbi Alokimin e Kapaciteteve në Avancë”,

Konstatoi se:

- OST sh.a me shkresën nr. DOS/DO/SMZ 3886 Prot., datë 25.05.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”, propozim i cili vjen në zbatim të dispozitave të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar me ligjin 7/2018, përkatësisht Neneve 56 dhe 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr.186 dt. 10.11.2017, përkatësisht nenit 104 “Modelet Individuale të Rrjetit, Modelet e Bashkuara të Rrjetit dhe Analizat e Sigurisë Operative”, si dhe nenet 58, 59, 60, 61, 62 të tij
- Dokumenti është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një metodologjie të modelit të përbashkët të rrjetit, përbëhet nga 25 nene dhe saktëson mënyrën e krijimit të modeleve individuale të rrjetit nga secila OST, të dhënat që duhet të përmbajnë modelet përfshi topologjinë, ngarkesën, gjenerimin si dhe mënyrën e bashkimit të këtyre modeleve në një të vetëm. Në këtë mënyrë do të bëhet në nivel Evropian analiza e sigurisë me qëllim përcaktimin e kapaciteteve të lira në avancë por edhe ato të ditës në avancë apo brenda ditës. Gjithashtu dokumenti përcakton krijimin e një platforme të vetme informacioni e cila do të shërbejë për grumbullimin e modeleve

individuale të rrjetit dhe bashkimin e tyre në modelin e përbashkët të rrjetit. Gjithashtu platforma do të kryejë analizën e flukseve për përcaktimin e kapaciteteve ndërkufitare.

- Kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat e përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore.
- Nevoja për implementimin e kësaj rregulloreje është theksuar edhe në mbledhjen Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë, Nr. 47, datë 30 qershor 2017 mbajtur në Vjenë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një Metodologji të Modelit të Përbashkët të Rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një Udhëzuesi mbi Alokimin e Kapaciteteve në Avancë”.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.